

KRYETARI I KUMUNËS SË GRAZ-IT I VIZITON SHQIPTARËT NË GRAZ

Sot për ne të gjithë është një gëzim i madhë dhe nder, në mënyrë të veçantë për **“Bashkësinë tonë Katolike Shqiptare”** në ipeshkëvinë Graz-Seckau, gjegjësisht në Graz, kur në mesin tonë dhe me ne është i pranishëm kryetari kryeqytetit të republikës së Steiermarkut, pra i kumunës së Graz-it **Mag. Siegfried Nagl**. Mirë se keni ardhë!

Ardhja e tij në mesin tonë, për ne dhe me ne është një shenjë dhe simbol i mirëkuptimit, koordinimit, bashkimit dhe e respektit reciprok. Ne jemi të ardhur nga shumë pjesë të ndryshme të Kosovës dhe mu në këtë vend kemi gjetur vendlindjen tonë të dytë dhe jemi të lidhur ngusht më me këtë famulli në St. Leonhard, me këtë qytet Graz dhe me shtetin Austri.

Me ne është sot një mik shumë i dashur i cili gjithnjë mundohet që ne t’ a shijojmë këtë mirasi që na ofron Graz-i dhe Austri në përgjithësi.

Qyteti i bukur është i lidhur ngusht me ne, jo vetëm sot kur në mesin tonë është i pranishëm kryetari i kumunës, por historia dëshmon se mu në këtë qytet janë shkolluar priftërinjtë tanë para ma shumë se 100 viteve duke na e dhuruar kulturën dhe shpirtin e këtij shteti në famullitë dhe në familjet tona. Sot pas shumë viteve kemi shumë student, (njëri ndër ta isha edhe unë gjatë viteve 1997-2003) nga të gjitha trojet shqiptare, të cilët përgatiten për një ardhmëri ma të mirë shkencorë ndër popullin tonë.

Shpeshherë në jetën tonë të përditshme disi në një mënyrë e përjetojmë dhe dëshirojmë që gjithmonë të gjindemi në qendër të vemendjes, ndoshta në të gjitha aspektet. Kjo mund të thojë është një tundim i egocentrizmit. Jezu Krishti ishte i ftuar tek një farisenj, ku ishin të pranishëm shumë të ftuar.

Ftesa ka të bëjë gjithmonë dhe ka lidhje me dashuri. Dikënd e fton se ke dashuri ndaj atij personi. Jezu Krishti ishte i ftuar jo pse ata e donin Jezusin, por se ata dëshironin ta provokonin. Mirë, Ai e pranon këtë ftesë dhe në kontekstin e dielës së sotme Jezu Krishti iu paraqet rregullat morale dhe sociale të njeriut në dasëm.

Këtu i paraqet dy rrugë: rruga **kryelartësisë dhe ajo e përvujtërisë**. Jezu Krishti në këto dy rrugë neve na tregon se si jeta e jonë krishtere mund të zhvillohet. Në njërin rrugë na ndalon që t’i përgjajmë asaj: që ne mos të jemi të orientuar vetëm në vetvete, të thojë të mos jam egocentrik në jetën time, që të jam vetëm në qendër të vemendjes. Kështu kur të vie dikush më i nderuar se unë të mos më thoti, **„Ilëshojë këtë vend, se nuk është për ty i rezervuar“!**

Këtu qëndrojmë në rrugën e kryenaltësisë dhe ne që ngritemi nga ana njerëzore do të jemi të ulur poshtë. Zoti nuk i don krenarët. Por, Jezusi na rrugën e dytë na urdhëron se si ne të sillemi kur të jemi të ftuar dhe të qëndrojmë në rrugën e përvujtërisë të udhehequr prej vet Zotit, që ne të ngritemi hyjnisht. Zoti i don të përvuajturit.

Sot kremtojmë **ditën e lindjes për qiellë të Nënës sonë Tereze**. Sot para 10 viteve ajo u largua nga kjo jetë takësore për ta vazhduar jetën qiellore. Në kanonin liturgjik kisha e kremton si të lumtur, sepse u ngrit na alterin e të gjithë të lumturve dhe të shenjtërve.

Kur gjindemi sot në 10 vjetorin e lindjes për qiell të së lumtërës Nënë Tereza, ajo edhe neve sot na tregon se si duhet të jetohet jeta jonë në përvujtëri dhe në shërbim Zotit me jetë dhe me vepra. Ajo na tregon se si jetohet me Krishtin dhe në Krishtin në përvujtëri! Jeta e secilit të krishterë, që jeton si i krishterë, dhe jeta e të lumturës Nënë Tereza lidhet ngusht me ungjillin e dielës së sotme: **“Të shkosh pas Jezusit do të thotë të liroshesh prej jetës tokësore që t’ mund t’i shërbesh Jezusit”**. Jeta e Jezu Krishtit dhe bashkjetesa me të dhe për të kërkon vetmohim edhe ndoshta prej më të afërmeve tanë. Jo në këtë mënyrë ekstreme të kuptohet ungjilli, por nëpërmjet këtyrë t’ mund ta gjëjmë Jezusin dhe atë ta lëmë në rend të parë të jetës sonë. Jeta me të është jeta në rrugë të kryqës, ajo rrugë që e kaloi vet Jezusi. Jezu Krishti nuk dëshiron që ne të guzhdohemi në kryq, por të jetojmë si Jezusi.

Sot kur kremtojmë ditën e së lumës Nënë Tereza, mund të shtronim pyetje, vallë a nuk jetoi ajo kështu, që la gjithçka pati dhe shkoi në shërbim Zotit? Ne mendojmë ndoshta që kjo nuk është e mundshme, por e dimë se Zoti është Ai që bënë që të realizohet e gjitha. Nënë Tereza është bërë simbol i bamirësisë në botë. Ajo u bë dritë për tërë humanizmin. Ajo me veprimtarinë e vet për dashuri ndaj Zotit dhe të afërmit shëndriti tërë botën, që bota e quan, Nënë. E lumtura është pors i yll në errësirë të mjerimit. Ndonese ajo ka vdekur, jeton në çdo vend e për gjithë kënd. Ajo është dhe u bë shpresa e Kishës.

Përvujtëria është të flasësh sa më pak për vetvetën.

Të mos përzihesh në punët e huaja.

T’i pranosh me gëzim kundërshtimet dhe përmirësimet.

Të kalosh dhe tejkalosh gabimet e huaja.

T’i pranosh edhe fyerjet.

T’i pranosh moskujdesin, harrimin dhe mosdashurinë.

Të mos kërkoj dashuri dhe kujdes të veçantë.

Të përgjigjesh burrërishtë edhe në provokime.

Kurre mos ta shkelësh dinjitetin e askujt

Të mos diskutosh edhe kur ke të drejtë.

Të zgjidhesh gjithmonë pjesën më të vështirë.

I nderuari zotëri kryetar, në emër të **„Bashkësisë sonë Katolike Shqiptare“** në Steiermark, gjegjësisht në Graz, Ju lutem që t’na përkrahni në nevojat tona, qofshin ato në aspektin politik, sportiv, shkencor, shoqëror, por edhe ndoshta në aspektin kishtar, që ne t’i bashkohemi bashkësisë suaj, që ne t’a gjejmë vetën në këtë qytet dhe të jetojmë ma të lirë. Një lutje direkte ju shkonë dhe ju lus me të vërtetë që „azilkërkuesve tanë t’ju ndihmoni“, që të fitojn leje qëndrimi në Austri.

Wir feiern heute den 22. Sonntag im Jahreskreis, den Tag des Herrn und wir wollen ihm ebenso am heutigen Tag danken. Unsere **„Albanische Katholische Gemeinde“** feiert mit unserem sehr geehrten Bürgermeister **Mag. Siegfried Nagl** die heilige Messe im Zeichen der Verbundenheit, der Liebe, Koordination und Brüderlichkeit.

Einen herzlichen Dank, dass Sie für uns Zeit genommen haben! Wir haben miteinander eine Brücke aufgebaut, zwischen uns selber, zwischen unserem Volk und unserer Kirche. Die schöne Stadt Graz ist mit uns sehr eng verbunden, nicht nur, wenn der Herr Bürgermeister in unserer Mitte ist, sondern die Geschichte sagt uns, dass in dieser Stadt viele Studenten Theologische Ausbildung gemacht haben und einige auch Priester geworden sind. Heute nach vielen Jahren passiert das gleiche, wir haben mehr als 200 Albanische Studenten auf der KF-UNI Graz, einer von denen war ich auch als Theologischer Student, wo ich im Jahre 2003 absolvierte. Es ist sehr schön, wenn wir die heilige Messe in unserer Albanischen Muttersprache erleben und feiern können! Für uns ist ein Geschenk, was für uns Graz, Steiermark bzw. Österreich tut.

Lieber Herr Bürgermeister heute sind Sie unser Gast in unserer kleinen albanischen Familie! Sie haben bei uns einen Ehrenplatz bekommen, „**Sie sind auch unser Bürgermeister**“! Jeder von uns ist im Dienst! Jeder von uns Getauften in eigenem Dienst hat Anteil an der Sendung Christi in der Kirche und durch die Kirche. Und diese Teilhabe an der Sendung Christi bildet die Kirche. Das ist die Kirche - das sind wir alle: eine lebendige Teilhabe an der Sendung Christi. Diese Kirche braucht unsere Kraft, unsere Begeisterungsfähigkeit, unsere Ideale, damit das Evangelium des Lebens in die soziale Struktur eindringen kann, um die Herzen der Menschen und die Gesellschaft zu wandeln, so dass eine Kultur wahrer Gerechtigkeit und Liebe entstehen kann.

Lieber Herr Bürgermeister im Namen unsere „**Albanischen Katholischen Gemeinde**“ in Graz bzw. in der Steiermark, habe ich eine Bitte an Sie, dass Sie unsere Anliegen, seien die im politischen, sportlichen, wissenschaftlichen Bereich unterstützen! Eine dringende Bitte haben unsere Asylbewerber, dass sie eine positive Antwort bekommen, um in Österreich bleiben zu dürfen. Amen

E përgatiti:
Mag. Don Kolë Gjergji,
Kapelan në famullitë
Vordernberg-Trofaiach-St. Peter
kolegjergji@hotmail.com